

VENDIM
Nr.956, datë 21.9.2009

PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANZIT TË PESË AUTOKOLONAVE USHTARAKE ITALIANE, PËRMES TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, pika 2, 17, 18 e 19 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Qafë-Thanë - porti i Durrësit, në datën 22 shtator 2009, të 5 (pesë) autokolonave ushtarake italiane dhe të personelit shoqërues, të përbëra si më poshtë vijon:

- Autokolona e parë, nga 20 (njëzet) automjete dhe 24 (njëzet e katër) trupa;
- Autokolona e dytë, nga 2 (dy) automjete, 5 (pesë) trupa;
- Autokolona e tretë, nga 15 (pesëmbëdhjetë) automjete dhe 32 (tridhjetë e dy) trupa;
- Autokolona e katërt, nga 19 (nëntëmbëdhjetë) automjete dhe 40 (dyzet trupa);
- Autokolona e pestë, nga 7 (shtatë) automjete dhe 14 (katërmëdhjetë) trupa.

2. Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë dhe pika e daljes është pika e kalimit të kufirit porti i Durrësit.

3. Autokolonat ushtarake italiane, gjatë hyrjes, lëvizjes dhe daljes në/nga territori i Republikës së Shqipërisë, të shoqërohen nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

4. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha